



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 11.6 të Ligjit për Teatrot nr. 04/L-106, nenit 12 paragraf 1.1 të Rregullores nr. 04/2015 për kushtet dhe kriteret e themelimit të teatrove kombëtare dhe të teatrove të qyteteve (MKRS) dhe nenit 16 të Statutit të komunës së Podujevës, Kryetari i komunës së Podujevës, merr;

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E KËSHILLIT DREJTUES TË TEATRIT PUBLIK TË QYTETIT “ AVDUSH HASANI “ NË PODUJEVË

Neni 1

Këshilli drejtues i Teatrit publik të qytetit “ Avdush Hasani “ në Podujevë, emërohet në përbërje:

1. Ramadan Oraca, aktor
2. Ismet Azemi, aktor
3. Melihate Aliu, dramaturge
4. Sabit Kopalla, prof i Gjuhës angleze
5. Xhevat Llugaliu, prof. i Gjuhës dhe letërsisë shqipe

Kryetari i Këshillit drejtues zgjedhet në mbledhjen e parë me shumicë absolute të votave të të gjithë anëtarëve.

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë dhe aktivitetet, Këshilli Drejtues, i ushtron në pajtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 3

Kryetarit të komunës, Këshilli drejtues i teatrit, i paraqet raport të punës së paku një (1) herë në vit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. 02-066-10463
Podujevë,
5 shkurt 2016

Kryetari i Komunës
Agim Veliu